

**VENDIM**  
**Nr.183, datë 2.3.2006**

**PËR ÇMIMIN, FORMËN, PËRMBAJTJEN, ELEMENTET E SIGURISË DHE  
PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME KARTËN E STUDENTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 2, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kartës së Studentit, si dokument unik, që përdoret nga të gjithë studentët e arsimit të lartë, publik e jopublik, me kohë të plotë në Republikën e Shqipërisë.
  2. Forma, përmbajtja dhe elementet e sigurisë së Kartës së Studentit të jenë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  3. Karta e Studentit lëshohet për një periudhë 1-vjeçare, kundrejt një çmimi prej 100 (njëqind) lekësh.
  4. Procedura e pajisjes me Kartën e Studentit është si më poshtë vijon:
    - a) Studenti regjistrohet në sekretarinë e universitetit, në fillim të vitit akademik, plotëson dhe depoziton formularin tip, i cili përmban të dhëna individuale për çdo student, fotografinë dhe kërkesën për të pajisur me Kartën e Studentit, shoqëruar me pagesën e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi;
    - b) Rektoratet e universiteteve, në fillim të vitit akademik, paraqesin në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në formë elektronike, listat me emrat e studentëve të regjistruar, që do të pajisen me Kartën e Studentit, si dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në shkronjën ”a”, të kësaj pike;
    - c) Rektoratet e universiteteve derdhin në llogarinë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shumën e mbledhur nga pagesa e tarifës për pajisjen me Kartën e Studentit, e cila kalon në zërin “Të ardhura dytësore”.
  5. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pajisjen e studentëve me kartë, krijon dhe administron bazën e të dhënave, për çdo student të pajisur me Kartën e Studentit, të cilën e përditëson çdo vit.
  6. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila plotëson kartat e studentëve, sipas kërkesave të rektorateve, bashkëpunon me rektoratet e universiteteve, qeveritë studentore dhe organizatat e ndryshme rinore, për çdo problem, që ka të bëjë me pajisjen e studentëve me Kartën e Studentit, dhe shkëmben në mënyrë të ndërsjellë informacione për bazën e të dhënave.
  7. Efekti financiar, prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, për prodhimin e Kartës së Studentit, për vitin akademik 2006-2007, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
  8. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi dhe rektoratet e universiteteve për shpërndarjen e Kartës së Studentit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**ANEKSI I**  
**FORMA, PËRMBAJTJA DHE ELEMENTET E SIGURISË TË KARTËS SË STUDENTIT**

I. Forma e Kartës së Studentit do të ketë këto të dhëna:

Dokumenti i Kartës së Studentit është i formatit ID1 dhe përmasat e tij janë:

gjatësi: 84 mm;

gjerësi: 54 mm;

trashësi 0.8 mm.

II. Përmbajtja dhe elementet e sigurisë kanë këto të dhëna:

1. Materiali do të jetë prej kartoni të plastifikuar ku janë të shtypura:

- Karta e Studentit

- Në krye të jetë: “stema e RSH dhe të shkruhet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve””.

- Emri, mbiemri i studentit;

- Datëlindja e studentit;

- Universiteti, dega, viti;

- Numri i serisë së Kartës së Studentit;

- Data e lëshimit të Kartës së Studentit;

- Periudha e vlefshmërisë.

2. Fotografia me ngjyra e mbajtësit të Kartës, jo më parë se tre muaj me përmasa 28 mm: 38 mm.

3. Vula e MTKRS, e cila përfshin një pjesë të fotos.

III. Pjesa e pasme e Kartës së Studentit do të ketë të dhënat dhe logon e prodhuesit të Kartës së Studentit, si dhe numrin e serisë të Kartës së Studentit.